

PARTIA E GJELBËR

# Raport i Audituesit të Pavarur

---

Partia e Gjelbër

AL - Margarita Kalemasi  
25/07/2018

Auditimi i Pasqyrave Financiare të Partia e Gjelbër për fondet e përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2017, u krye bazuar në Ligjin Nr. 10019 datë 29/02/2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar; Vendimit të KQZ datë 27.04.2018 si dhe Kontratën e Shërbimit Nr. 542/1 datë 06.06.2018.

## Tabela e përmbajtjes

A. RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR .....	1
B. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	3
C. PASQYRA AKTIVITETEVE.....	4
D. PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE .....	5
E. SHENIME SHPJEGUESE.....	6

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga PARTIA E GJELBËR për vitin 2017

Drejtuar: KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE (K.Q.Z)

PARTIA E GJELBËR

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Partia e Gjellbër ("Organizata"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e aktiviteteve, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës më 31 dhjetor 2017, dhe rezultatin e saj financiar dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse (SKK për OJF-të).

### Baza për Opininin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe Palëve të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK për OJF-të, si edhe sistemin e kontrollit të brëndshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Organizatës për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Organizatës, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart.

Drejtimi është përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.



## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR


### Për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga PARTIA E GJELBËR për vitin 2017


Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazaë për opinionit tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brëndshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinionin mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brëndshme të Organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyestuehmërinë, e çmuarjeve kontabël si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmëndjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së S Organizatës për të vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me drejtimin e Partia e Gjellbër, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

  
Margarita Kalemasi  
Auditues Ligjor



25 Korrik 2018  
Tiranë, Shqipëri

Margarita Kalemasi – Auditues Ligjor – Liçensë Nr. 156  
Rr. Asim Vokshi – Nd. 14, H. 6, Ap. 27, Tiranë, Shqipëri  
t: +355 4 242 0666, e: [m.kalemasi@joncon.al](mailto:m.kalemasi@joncon.al)

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga PARTIA E GJELBËR për vitin 2017

### 1. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

AKTIVET	2017	2016
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	25,398	35,010
Të tjera afat gjata (mobilje zyre dhe informatike)	149,157	86,900
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>174,555</b>	<b>121,910</b>
<b>DETYRIMET</b>		
Të pagueshme	35,010	35,010
1. Paga	26,640	26,640
2. Sigurime	8,370	8,370
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>35,010</b>	<b>35,010</b>
<b>AKTIVET NETO</b>		
<i>Të kufizuara</i>	-	-
a) Tokë ose vepra arti të dhuruara për t'u përdorur për qëllime specifike me përcaktimin që të ruhen apo të mos shiten	-	-
b) Aktive të dhuruara me qëllimin për t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime të përhershme të ardhurash	-	-
<i>Të pakufizuara</i>	139,545	86,900
<i>Të mbartura</i>	86,900	
<i>Shtesa / Pakësime të vitit</i>	52,645	
<b>Totali i aktiveve neto</b>	<b>139,545</b>	<b>86,900</b>

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga drejtimi i Organizatës më 22 Mars 2018 dhe janë firmosur nga:

Edlir Petanaj  
Kryetar i PGJ

Andi Hoxha  
Hartues i pasqyrave financiare

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga PARTIA E GJELBËR për vitin 2017

### 2. PASQYRA E AKTIVITETEVE

Përshkrimi i zërit	2017	2016
Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:	-	-
<b>Të ardhurat:</b>		
Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit	75,000	35,194
Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit	2,067,352	2,246,205
<b>Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara</b>	<b>2,142,352</b>	<b>2,281,399</b>
<b>Aktive neto të çliruara nga kufizimet:</b>		
Realizimi i kufizimeve të programit	-	-
Realizimi i kufizimit për blerjen e pajisjeve	-	-
Përfundimi i kufizimit të afatit	-	-
<b>Totali i aktiveve neto të çliruara nga kufizimet</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara:</b>	<b>2,142,352</b>	<b>2,281,399</b>
<b>Shpenzime sipas programeve</b>		
Aktiviteti A	2,067,982	2,194,499
Aktiviteti B	-	-
Aktiviteti C	-	-
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	21,725	-
Krijim dhe rritje fondesh	-	-
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>2,089,707</b>	<b>2,194,499</b>
<b>Rritja/Rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)</b>	<b>52,645</b>	<b>86,900</b>
<i>Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:</i>		
Kontributet	-	-
Të ardhurat nga investimet afat gjata	-	-
Fitimi i realizuar dhe i porealizuar nga investimet afatgjata	-	-
Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor	-	-
Aktivitet neto të çliruara nga kufizimet (me shenjë minus)	-	-
<b>Rritja/Rënia në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (B)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b><i>Ndryshimi në aktivet neto (A + B)</i></b>	<b>52,645</b>	<b>86,900</b>
Aktive neto në fillim të vitit	86,900	
<b>Aktive neto në fund të vitit</b>	<b>139,545</b>	

**RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

Për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga PARTIA E GJELBËR për vitin 2017

**3. PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE**

Përshkrimi i zërave	<u>2017</u>	<u>2016</u>
<b>Flukset nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>		
Para të arkëtuara nga kontribute të pakufizuara	2,142	2,163
Të paguara për punonjësit	(420)	(2,282)
Të paguara për furnitorët	(1,648)	-
<b>Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>	<u>74</u>	<u>(119)</u>
<b>Flukset nga aktivitetet investuese</b>		
Blerje/Shitje të aktiveve afatgjata materiale	(84)	-
<b>Flukse neto nga aktivitetet investuese</b>	<u>(84)</u>	<u>-</u>
<b>Flukse nga aktivitetet financuese</b>		
Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma	-	-
Interesa dhe dividendë të kufizuar për qëllime në terma afatgjatë	-	-
Principal i paguar për dëftesat e pagueshme	-	-
<b>Flukse neto nga aktivitetet financuese</b>	<u>-</u>	<u>-</u>
<b>Rritje / Rënie neto e flukseve</b>	<u>(10)</u>	<u>(119)</u>
Gjendje në fillim të periudhës	35	154
Gjendje në fund të periudhës	<u>25</u>	<u>35</u>

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga PARTIA E GJELBËR për vitin 2017

### 4. SHËNIME SHPJEGUSE

Organizata i ndërton dhe i paraqet Pasqyrat Financiare në përputhje me Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar, neni 4, dhe në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jofitimprurëse (SKK për OJF-të). Në vijim shpjegohen vlerat e paraqitura në pasqyrat përkatëse.

#### AKTIVET

Aktive monetare të cilat arrijnë në fund të vitit në vlerën 25,398 lekë, nga të cilat 3.94 Euro (kursi i këmbimit 132.95) dhe 24,874 lekë.

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Para në arkë	2,876
Para në bankë në LEK	21,998
Para në bankë në monedhë të huaj	524
<b>Totali i parasë dhe ekuivalentëve të saj</b>	<b><u>25,398</u></b>

Të tjera afatgjata përfaqëson investime për pajisje zyre në vlerën 83,982 lekë.

#### DETYRIMET

Detyrimet afatshkurtra përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Paga e muajit dhjetor 2017	26,640
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	8,370
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	<b><u>35,010</u></b>

#### PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Kontributet e anëtarëve dhe donacionet për vitin 2017 janë 2,241,352 lekë.

Shpenzimet e vitit 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime për aktivitete	1,302,500
Shpenzime pagash	360,000
Udhëtime e dieta	199,926
Antarsime ne Organizata të huaja	64,505
Kontributet e sigurimeve	60,120
Shpenzime auditimi	56,000
Shpenzime amortizimi	21,725
Taksa lokale	15,816
Shërbime bankare	9,108
Humbje nga konvertimi	6
	<b><u>2,089,706</u></b>